



SHËNOHET 26-VJETORI I NDËRHYRJES SË NATO-S
DHE 27-VJETORI I EPOPESË SË DUKAGJINIT

KOSOVA KUJTON DY NGA DATAT E RËNDËSISHME TË LIRISË

FAQE 4-5



Në Glllogjan të hënën është shënuar 27-vjetori i Epopesë së Dukagjinit. Për ta nderuar këtë përvjetor kishin ardhur presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, familja Jashari, kryetarë komunash, përfaqësues

të FSK-së, të OVLUÇK-së dhe qytetarë të shumtë. Osmani ka thënë se Epopeja e Dukagjinit ishte një nga çastet më të ndritura të luftës sonë për liri. Ndërkaq Konjufca ka theksuar se atë ditë kumboi fuqishëm thirrja e lirisë, që u bë frymëzim për të

gjithë popullin shqiptar. Ish-komandanti i UÇK-së për rajonin e Dukagjinit, Ramush Haradinaj, ka thënë se ditë më të mirë dhe më të madhe shqiptarët nuk kanë përjetuar në historinë e vet sesa 24 marsin e '99-s

101 DEPUTETË KËRKOJNË PAGËN KALIMTARE PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT TË KUVENDIT

F.3



TUBERKULOZI MBETET NJË NGA SFIDAT KRYESORE SHËNDETËSORE NË BOTË, AS KOSOVA NUK BËN PËRJASHTIM

F.7



HIQET BLOKADA E SHKAKTUAR NGA LIGJI PËR PRONËN PUBLIKE

F.8

SPORT



FODA: ISHA I BINDUR SE DO TË NGJITESHIM NË LIGËN B

F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Vazhdojnë protestat masive në Turqi kundër arrestimit të rivalit të Erdoganit, Imamoglu

STAMBOLL, 24 MARS - Dhjetëra mijëra njerëz protestuan në Stamboll dhe në qytete të tjera nëpër Turqi për natën e pestë radhazi të dielën, pasi rivali kryesor politik i presidentit të vendit, Recep Tayyip Erdogan, Ekrem Imamoglu, u arrestua formalisht dhe u akuza për korrupsion. Polica ka përdorur gaz lotsjellës, plumba gome dhe topa uji kundër protestuesve, të cilët po valëvitnin flamuj turq dhe po mbanin në duar pankarta pro-opozitës. Thuhet, gjithashtu, se ka pasur përlëshje mes policëve dhe protestuesve. Imamoglu, kryetar i Stambollit, pritej të zgjidhej gjatë një votimi më 23 mars si kandidat i Partisë Republikane Popullore (CHP) për zgjedhjet e ardhshme presidenciale në Turqi, të planifikuara për vitin 2028. Por, Imamoglu dhe dhjetëra të tjerë, përfshirë politikanë, gazetarë dhe sipërmarrës, u ndaluan më 19 mars si pjesë e një hetimi kundër korrupsionit. Kryetari i njohur i Stambollit u arrestua formalisht më 23

mars dhe u akuza për “themelimin dhe menaxhimin e një organizate kriminale, marrjen e ryshfetit, përvetësimin” dhe vepra të tjera penale. Imamoglu - i cili është anëtar i CHP-së, partisë kryesore opozitare kundër aleancës qeverisëse të Erdoganit - ka mohuar akuzat kundër tij, duke i përshkruar ato si “akuza dhe shpifje të paimagjinueshme”. “Nuk do të përulem kurrë”, shkroi Imamoglu në X para se të arrestohej. Arrestimi i Imamoglut shihet si akt i motivuar politikisht për ta larguar atë nga gara presidenciale. Megjithatë, qeveria këmbëngul se gjykatat e vendit janë institucione të pavarura. Bashkëshortja e Imamoglut, Dilek Kaya Imamoglu, iu drejtua protestuesve pranë bashkisë së Stambollit në mbrëmjen e së dielës, duke u thënë se “padrejtësia” që ka përjetuar bashkëshorti i saj ka “prekur çdo ndërgjegje”. Arrestimi i Imamoglut dhe të tjerëve ka përshkallëzuar më



tej tensionet politike dhe ka nxitur protesta në mbarë Turqinë, me demonstrues që janë mbledhur në të paktën 55 provinca për ta shprehur mbështetjen e tyre për të. Ministri i Brendshëm i Turqisë, Ali Yerlikaya, shkroi në rrjetet sociale se mbi 340 persona u arrestuan gjatë protestave në qytetet kryesore. “Nuk do të ketë tolerancë për ata që kërkojnë

ta prishin rendin shoqëror, ta kërcënojnë paqen dhe sigurinë e popullit dhe mbjellin kaos e provokime”, tha ai, duke përmendur qytetet, mes të cilëve Stambolli, Ankaraja, Izmiri, Adana, Antalia, Çanakale, Eskişehir, Konia dhe Edrene. Megjithatë, kryetari i Bashkisë së Ankarasë, Mansur Yavas, i cili është gjithashtu anëtar i CHP-së, u tha gazetarëve të

dielën se burgosja e kolegut të tij është turp për sistemin gjyqësor. Kryetari i CHP-së, Ozgur Ozel, e dënoi arrestimin e Imamoglut si “përpjekje për grusht shteti kundër presidentit tonë të ardhshëm”. Disa vende evropiane kanë shprehur shqetësim për zhvillimet në Stamboll, duke thënë se kanë frikë për pasojat ndaj demokracisë pas këtij veprimi. “Arrestimi i kryebashkiakut është thellësisht shqetësues”, tha presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. “Turqia duhet t’i respektojë vlerat demokratike, veçanërisht të drejtat e zyrtarëve të zgjedhur”, shtoi ajo. Imamoglu kryeson ndaj Erdoganit në disa sondazhe. Erdogani e ka arritur kufirin e dy mandateve si president, pasi më parë ka shërbyer si kryeministër i vendit. Nëse ai kërkon të garojë përsëri, siç pritet, duhet ose të shpallë zgjedhje të parakohshme ose ta ndryshojë Kushtetutën.

Negociatorët amerikanë takohen me ekipin rus në Riad pas bisedimeve me Ukrainën

KIEV, 24 MARS - Zyrtarët amerikanë dhe rusë janë duke zhvilluar bisedime në Arabinë Saudite, në përpjekje për ta arritur një marrëveshje për armëpushim në Ukrainë. Bisedimet e së hënës po zhvillohen një ditë pasi Shtetet e Bashkuara dhe Ukraina mbajtën bisedime ndaras, të cilat Kiev i cilësoi si “frytdhënëse”. ShBA-ja dhe Rusia pritet të bisedojnë për hollësitë e një ndërprerjeje afatgjate të sulmeve nga Rusia dhe Ukraina kundër infrastrukturës së energjisë dhe asaj civile, si dhe për ndaljen e sulmeve në Detin e Zi. Thuhet se ekipi amerikan po udhëhiqet nga Andrew Peek, drejtor në Këshillin e Sigurisë Kombëtare të Shtëpisë së Bardhë, dhe Michael Anton, zyrtar i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit. Ekipi rus po përfaqësohet nga Grigory Karasin, kryetar i Komisionit për Çështje të Jashtme në Parlamentin e Rusisë, dhe Sergei Beseda, këshilltar i drejtorit të Shërbimit Federal të Sigurisë, sipas mediave ruse. Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha se bisedimet mes Moskës dhe Uashingtonit përqendrohen në çështje teknike, përfshirë në sigurinë e transportit tregtar në rajon. Ekipi i Uashingtonit nuk ka komentuar ende bisedimet me përfaqësuesit e Kievit, por ministri i Mbrojtjes i Ukrainës,



Rustem Umerov, tha se bisedimet ishin “konstruktive dhe kuptimplota”. “Diskutimet ishin frytdhënëse dhe të përqendruara. Adresuam çështje kyçe, përfshirë energjinë”, shkroi Umerov në Facebook. “Qëllimi i presidentit Volodymyr Zelensky është ta sigurojë një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme për vendin dhe popullin tonë - dhe për gjithë Evropën. Ne po punojmë për ta arritur këtë synim”, shtoi ai. Bisedimet në Riad shënuan një moment historik në përpjekjet e udhëhequra nga SHBA-ja për ta arritur një armëpushim në luftën në Ukrainë. Më parë, ka pasur ndërprerje prej një ose më shumë ditësh midis rundeve të ndryshme të bisedimeve dypalëshe.

Megjithatë, edhe pse negociatorët rusë dhe ukrainas do të jenë në të njëjtin vend teksa zhvillojnë bisedime me delegacionin amerikan, pak njerëz presin ndonjë përparim të madh. Zelensky, duke folur derisa bisedimet po zhvilloheshin, tha se “ekipi ynë po punon në një mënyrë plotësisht konstruktive”. “Biseda është mjaft e dobishme - puna e delegacioneve po vazhdon”, shtoi ai. “Por, pavarësisht se çfarë u themi sot partnerëve tanë, ne duhet ta bëjmë [presidentin rus Vladimir] Putin të japë urdhër të vërtetë për t’i ndaluar sulmet. Kushdo që e solli këtë luftë, duhet ta ndalojë atë”, nënvizoi Zelensky. Zyrtarët amerikanë kanë shprehur optimizëm para

takimeve në Arabinë Saudite. “Mendoj se të hënën do të shihni një përparim të vërtetë në Arabinë Saudite”, tha për Fox News i dërguari amerikan, Steve Witkoff, më 22 mars. Kievit dhe Moska kanë qenë më të përmbajtur në pikëpamjet e tyre. Në Rusi, ku Radio Evropa e Lirë është shpallur organizatë e padëshirueshme dhe është praktikisht e ndaluar, ishte zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ai që shoi çdo shpresë për një marrëveshje të shpejtë. “Nuk duhet të kemi pritshmëri të larta. Një punë shumë serioze dhe e madhe na pret. Do të duhet të futemi në hollësi”, tha ai në një intervistë për televizionin shtetëror të dielën. “Jemi vetëm në fillim të kësaj rruge”, shtoi ai. Diplomatat rusë dhe ukrainas nuk planifikohet të takohen drejtpërdrejt. Në vend të kësaj, ata pritet të takohen veçmas me ekipin amerikan, në atë që një zyrtar amerikan e përshkroi si “diplomaci me ndërmjetësim”. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka qenë deri më tani më i vendosuri në favor të negociatave. Por, shpresat e tij për përparim të shpejtë kanë hasur në pengesa të vazhdueshme. Së pari, një plan i rënë dakord me Ukrainën për një armëpushim të përgjithshëm 30-ditor u bllokua nga Putin. Pas një telefonate me Putinin, Trump tha se ata ishin pajtuar për një ndërprerje të sulmeve ndaj infrastrukturës.

Por, Kremlini e ngushtoi edhe më tej këtë fokus, duke thënë se marrëveshja lidhej vetëm me infrastrukturën energjetike - të cilën forcat e tij e sulmuan gjithsesi. Ukraina shpreson ta qartësojë këtë çështje në Xhedah, duke sjellë një listë të asaj që Rusia duhet të pranojë të mos e shënjestrojë. Mjegull e ngjashme ishte edhe pas bisedimeve mes Trumpit dhe Zelenskyyt. Derisa zyrtarët amerikanë flisnin për një plan të ri për pronësinë amerikane të centraleve bërthamore ukrainase, si një formë e garancive të sigurisë për Ukrainën, Zelensky e bëri të qartë se këto centrale janë pronë shtetërore që u përkisnin të gjithë ukrainasve. Ndërkohë, u tha përsëri se një marrëveshje dypalëshe për mineralet e rralla të Ukrainës është pothuajse gati. Por, ende nuk ka qartësi se kur do të nënshkruhet dokumenti - i cili, siç duket, përmban më shumë aspirata sesa hollësi konkrete. Në bisedimet e reja në Arabinë Saudite pritet të shtjellohet edhe një temë tjetër. Witkoff, i dërguari amerikan, tha se do të ketë përparim në “një armëpushim në Detin e Zi, për anijet midis të dyja vendeve. Dhe nga aty, do të kalojmë natyrshëm në një armëpushim të plotë”. Witkoff, gjithashtu, tha se është i bindur se Putini dëshiron paqen, diçka që Ukraina dhe vendet evropiane nuk e besojnë.

101 DEPUTETË KËRKOJNË PAGËN KALIMTARE PAS PËRFUNDIMIT TË MANDATIT TË KUVENDIT



Prishtinë, 24 mars - E shtuna e 22 marsit 2025 ka qenë dita e fundit e mandatit të legjislativës së tetë të Kuvendit të Kosovës. Me përfundimin e këtij mandati, deputetëve që nuk kanë të hyra të tjera, ligjërisht u takon paga kalimtare për një periudhë deri në 12 muaj.

Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit e përcakton se paga kalimtare u takon ligjvënësve deri në fillimin e realizimit të të hyrave financiare nga ndonjë burim tjetër, ose nga realizimi i pensionit. Siç nuk u takon atyre që kanë të hyra të tjera, paga kalimtare s'u takon as atyre që rizgjidhen deputet.

Paga bazë e deputetit është mbi 1 800 euro.

Kallxo.com ka kërkuar qasje në Kuvendin e Kosovës për të marrë vesh se cilët janë deputetët që kanë kërkuar të marrin këtë pagë. Me këtë rast, Kuvendi i Kosovës ka njoftuar se 101 deputetë kanë kërkuar ta shfrytëzojnë të drejtën e përfitimit të pagës kalimtare.

Nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje për pagë kalimtare kanë aplikuar: Adelina Grainca, Adnan Rrustemi, Adriana Matoshi, Agon Batusha, Alban Bajrami, Arbër Rexhaj, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Arijeta Rexhepi, Arjeta Fejza, Armend Muja, Arta Bajralija, Artan Abrashi, Avni Dehari, Besim Muzaqi, Burim Meta, Dimal Basha, Driton Hyseni, Enver Dugolli, Enver Haliti, Fatmire Kollçaku, Fitim Haziri, Fitore Pacolli-Dalipi, Fjolla Ujkani, Gani Krasniqi, Gazmend Gjyshinca, Halil Thaqi, Haxhi Avdyli, Hydajet Hyseni-Kaloshi, Jahja Kokaj, Jeta Statovci, Jetmire Vrenezi, Labinotë Demi-Murtezi, Luan Aliu, Mefail

Bajqinovci, Milazim Salijaj, Mimoza Kusari-Lila, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Mirsad Shkreta, Nasuf Bejta, Nijazi Isaku, Salih Zyba, Shqipe Isufi, Shqipe Mehmeti-Selimi, Tinka Kurti, Valon Ramadani, Vendenis Lahu, Visar Korenica, Yllza Hoti.

Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës që kanë kërkuar pagën kalimtare janë: Abelard Tahiri, Arianë Musliu-Shoshi, Blerta Deliu-Kodra, Eliza Hoxha, Elmi Reçica, Florete Zejnullahu, Ganimete Musliu, Hajdar Beqa, Hisen Berisha, Isak Shabani, Memli Krasniqi, Mergim Lushtaku, Rashit Qalaj dhe Xhavit Haliti.

Nga grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për këtë pagesë kanë parashtruar kërkesë deputetët: Agim Veliu, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Besian Mustafa, Doarsa Kica-Xhelili, Drita Millaku, Driton Selmanaj, Hykmete Bajrami, Marigona Geci, Rrezarta Krasniqi, Valentina Bunjaku-Rexhepi dhe Vlorë Dumoshi.

Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës pagën kalimtare e kanë kërkuar: Albana Bytyqi, Albena Reshitaj (tash LV), Bekë Berisha, Besnik Tahiri, Haki Abazi, Pal Lekaj, Shemsedin Dreshaj dhe Time Kadrijaj.

Pagë kalimtare ka kërkuar edhe Fatmir Humolli, i cili deri në përfundim të mandatit ishte pa grup parlamentar.

Deputetët e komuniteteve joshumicë, joserbe, që kërkuar pagën kalimtare janë: Adem Hoxha, Bekim Arifi, Duda Balje, Enis Kervan, Erxhan Galushi, Fidan Jilta, Fridon Lala dhe Samra Iljaz.

Nga grupi parlamentar i Listës Serbe pagë kalimtare kanë kërkuar: Blijana Maksiq, Cvetko

Veljković, Milan Joksimović, Milan Kostiq, Nenad Radenković, Olivera Zdravković, Rados Mihajlović, Svetislav Jokić dhe Zoran Maksimović.

Nga 120 deputetët e Kuvendit të Kosovës, vetëm 19 nga ta nuk kanë paraqitur kërkesë për kompensim kalimtar.

Deputetët që nuk e kërkuar këtë kompensim janë: Ardian Kastrati, Ardian Gola, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Behgjet Pacolli, Bekim Haxhiu, Ekrem

Mustafa, Eman Rrahmani, Enver Hoxhaj, Fadil Gashi, Ferat Shala, Fitim Uka, Glauk Konjufca, Gramoz Agusholli, Lumir Abdixhiku, Ksenija Bozović, Kujtim Shala, Ramush Haradinaj dhe Saranda Bogujevci.

Më 22.03.2021 ishte mbajtur seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës e më pas ishte thirrur seancë e jashtëzakonshme dhe në po të njëjtën ditë edhe ishte votuar Qeveria Kurti 2.

Sipas Kushtetutës së Republikës

së Kosovës, Kuvendi i Kosovës ka mandat 4-vjeçar nga dita e seancës konstituive. Pas përmbylljes së këtij mandati, i vetmi organ që e ruan vijimësinë e punës së Kuvendit deri në konstituimin e legjislativës së re është Kryesia e Kuvendit.

Me përfundimin e mandatit kushtetues të Kuvendit, ka përfunduar edhe mandati i rregullt i qeverisë. Nga 23 marsi, qeveria e drejtuar nga Albin Kurti është me kompetenca të kufizuara.



FSK-ja bën homazhe në Kompleksin Memorial në Glogjan

Deçan, 24 mars - Me rastin e shënimit të 27-vjetorit të "Epopesë së Dukagjinit", të hënën oficerë të lartë të

Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të Ministrisë së Mbrojtjes kanë bërë homazhe në Kompleksin Memorial në

Glogjan, në nderim të të rënëve dhe luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



SHËNOHET 26-VJETORI I NDËRHYRJES SË NATO-S DHE 27-VJETORI I EPOPESË SË DUKAGJINIT

KOSOVA KUJTON DY NGA DATAT E RËNDËSISHME TË LIRISË

Në Glogjan të hënën është shënuar 27-vjetori i Epopesë së Dukagjinit. Për ta nderuar këtë përvjetor kishin ardhur presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, familja Jashari, kryetarë komunash, përfaqësues të FSK-së, të OVLUÇK-së dhe qytetarë të shumtë. Osmani ka thënë se Epopeja e Dukagjinit ishte një nga çastet më të ndritura të luftës sonë për liri. Ndërkaq Konjufca ka theksuar se atë ditë kumboi fuqishëm thirrja e lirisë, që u bë frymëzim për të gjithë popullin shqiptar. Ish-komandanti i UÇK-së për rajonin e Dukagjinit, Ramush Haradinaj, ka thënë se ditë më të mirë dhe më të madhe shqiptarët nuk kanë përjetuar në historinë e vet sesa 24 marsin e '99-s

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

DEÇAN, 24 MARS - Presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, familja Jashari, kryetarë komunash, përfaqësues të FSK-së, të OVLUÇK-së dhe qytetarë të shumtë, kanë qëndruar të hënën në Glogjan për ta nderuar 27-vjetorin e Epopesë së Dukagjinit. Presidentja Osmani, e cila është pritur në kullën e Haradinajve në Glogjan nga Ramush Haradinaj, ka thënë se Epopeja e Dukagjinit është flakadan i lirisë. “Në këtë përvjetor të lavdishëm ishim në Glogjan që ta kujtojmë dhe nderojmë Epopenë e Dukagjinit, një nga momentet më të ndritura të luftës sonë për liri. Në themelet e Kosovës së pavarur qëndron sakrifica e heronjve të UÇK-së, e familjes Haradinaj dhe e të gjithë atyre që u ngritën kundër padrejtësisë, për lirinë dhe shtetin tonë. Me nderimin më të madh përkulemi para dëshmorëve Himë Haradinaj,

Gazmend Mehmetaj dhe Agron Mehmetaj, që dhanë jetën në këtë datë, për të mos vdekur kurrë. Ata u bënë simbol i rezistencës, guximit dhe besimit në lirinë e Kosovës. Në Kosovën e pavarur dhe sovranë, amaneti i heronjve na obligon ta ndërtojmë një shtet të fortë, dinjitoz, të përparuar e me aleanca të fuqishme. Liria është trashëgimia e tyre e përgjegjësi e jona! Lavdi dëshmorëve të kombit! Nderim i përhershëm UÇK-së!”, ka thënë Osmani. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se këtu e 27 vjet më parë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të zhvillonte një betejë të lavdishme frontale përballë forcave pushtuese të Serbisë, të cilën e përkujtojmë si Epopeja e Dukagjinit. “Forcat e armikut e rrethuan Glogjanin më 24 mars 1998, duke synuar ta thyejnë atë vatër të rezistencës frymëzuese. Trimëria, vendosmëria dhe gatishmëria për të luftuar deri në fund i dha mesazhin e qartë Serbisë okupatore se asnjë rrethim nuk do të mund ta

shuante përpjekjen për liri. Atë ditë kumboi fuqishëm thirrja e lirisë, që u bë frymëzim për të gjithë popullin shqiptar e në mbarë Kosovën, duke dhënë shembullin e lartësuar të rezistencës me armë në duar, të sakrificës në emër të aspiratës sonë të përbashkët çlirimtare. Duke përkujtuar këtë betejë të shndritshme dhe për ta nderuar sakrificën sublime të dëshmorëve Himë Haradinaj, Gazmend e Agron Mehmetaj, sot bëra homazhe në Kompleksin Memorial ‘Dëshmorët e Kombit’ në Glogjan. Vepra e tyre heroike do të mbetet e paharruar, duke na frymëzuar neve dhe brezat e ardhshëm. Dëshmorët dhe të gjithë të rënë janë ata që i hapën rrugën ngritjes së Republikës sonë dhe ne kurrë nuk duhet të harrojmë se sa shumë u desh të përpiqemi e të japim për ta fituar lirinë. Lavdi Himë Haradinajt, Gazmend e Agron Mehmetajt, që me gjakun e tyre e shënuan madhësinë e Epopesë së Dukagjinit, si dhe të gjithë

dëshmorëve që dhanë jetën për liri!”, ka thënë Konjufca.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ish-komandant i UÇK-së, ka folur për historikun e kësaj beteje ndaj forcave serbe. “Nga 24 marsi 1998 dhe deri më 24 mars 1999 shumë bashkëluftëtarë të zot u ndanë në ne, shumë civilë u vranë, djegie, shkatërrime, momente më të dhimbshme dhe të vështira. Ditë më të mirë dhe më të madhe shqiptarët nuk kanë përjetuar në historinë e vet sesa 24 marsin e vitit 1999. Në atë kohë NATO-ja, e prirë nga Amerika, hyri në luftë. Hyri duke sulmuar armikun tonë, forcat e Millosheviqit, regjimin e Millosheviqit, duke bombarduar atë edhe në vendluftime që menjëherë na krijonte epërsi, por duke bombarduar edhe në Beograd. Kjo është e vërteta e historisë sonë. Na ka pa Zoti atë ditë, se pa atë ditë do ta kishim vështirë për ta mbërritur këtë ditë që gëzojmë sot. Këtë nuk po ua thotë dikush që e ka pa prej së largu luftën. Këtë po jua thotë dikush që asnjë ditë të luftës nuk e ka lëshuar vendluftimin”, ka thënë Haradinaj. Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, duke folur për 27-vjetorin e Epopesë së Dukagjinit, ka thënë se në Glogjan u mbledhën për ta shënuar 24 marsin, datë në të cilën historia e popullit tonë mori kthesën e duhur dhe rrugën drejt lirisë, për të cilën punuan dhe u sakrifikuan shumë breza. “Kjo datë na kujton vuajtjet, vetëmohimin, krenarinë dhe përkushtimin për mbrojtjen e identitetit tonë,

vlera që kanë qëndruar të forta përtej kohës, ndër shekuj”, ka thënë Ramosaj.

Ai ka shtuar se që një datë të jetë historike e të nderohet përjetësisht, patjetër duhet të ketë heronjtë e luftëtarët e saj. “Heronjtë dhe dëshmorët e kësaj dite të dhimbshme dhe padhështore. E them e dhimbshme sepse atë ditë ranë tre bashkëluftëtarë të Luanit të UÇK-së, Gazmend Mehmetaj, Himë Haradinaj e Agron Mehmetaj. Humbja e tyre vazhdon të jetë një plagë e thellë në zemrat tona dhe një burim krenarie kombëtare”, ka thënë Ramosaj.

Ai ka shtuar se heronjtë e gjallë të asaj dite, nën emblemën e UÇK-së, familja e shenjtë e Haradinajve, bëri atë që përgjatë historisë sonë si komb ishte e paparë dhe e padëgjuar ndonjëherë. “Shumë e vështirë ta thuash me fjalë historinë prej luftëtarë që bëri atë ditë komandanti i Zonës Operative të Dukagjinit, gjenerali Ramush Haradinaj. Në këtë ditë lindi dhe u brumos shpresa jonë, që liria për ne tashmë kishte ardhur pavarësisht çmimit të madh që paguam si komb. Nderim përjetësisht 24 marsit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjes emblematike të Hilmi Haradinaj! Lavdi e nderim përjetësisht për dëshmorët dhe martirët e kombit! Mirënjohës pafundësisht për 24 Marsin e vitit 1999, ndërhyrjes së trupave të NATO-s, prirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës!”, ka theksuar Ramosaj.

Për ta shënuar Epopenë e Dukagjinit ishte i pranishëm



edhe ish-kryetari i komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, djali i heroit të Hamëz Jasharit, së bashku me bacën Rifat. Ata nderuan dëshmorët e betejës së Glogjanit. “Kosova është e mbushur me varre dëshmorësh që dëshmojnë sakrificën dhe heroizmin, me masakra që janë dëshmi e gjenocidit serb, dhe me kullat që mbeten simbol i qëndresës dhe heroizmit të popullit tonë në luftën për liri dhe pavarësi. Sot, bashkë me mixhën e dashur, Rifat, nderuam dëshmorët e betejës së Glogjanit, në shënim të 27-vjetorit të kësaj ngjarjeje historike, ku më 24 mars 1998 ranë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”, ka thënë Bekim Jashari.

Ai ka treguar se sot kujtojnë e nderojnë Himë Haradinajn, Gazmend dhe Agron Mehmetajn, vëllezërit Luan e Shkelzen Haradinaj dhe të gjithë dëshmorët e Dukagjinit që dhanë jetën për lirinë që sot po e gëzojmë.

“Lavdi dëshmorëve dhe martirëve të Lirisë!”, ka theksuar ai.

26 vjet nga ndërhyrja e NATO-s në Kosovë

24 mars 1999. Pak pas orës 19:00 në kryeqytetin e Serbisë, Beograd, dëgjohen sirenat e para. Ato paralajmërojnë ushtarakë të NATO-s mbi qellin e Serbisë. Pak para orës 21:00 dëgjohet një shpërthim i fuqishëm në fabrikën e aeroplanëve “Lola Utva”, në Pançevë të Serbisë. Flaka dhe tymi mbulon këtë lokacion në periferi të Beogradit. Ky moment shënon fillimin e një fushate 78-ditore të bombardimit të Jugosllavisë.

Aeroplanë të NATO-s bombarduan në territorin e Serbisë, Kosovës dhe Malit të Zi. Mes dilemash dhe kundërshtimesh nga Kina dhe Rusia, atëbotë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, më 23 mars 1999, në orën 22:17, urdhëroi një sulm ajror mbi Republikën Federale të Jugosllavisë.

Arsyetimi, në Serbi nuk ka

gatishmëri për zgjidhje politike të krizës së Kosovës.

Sulmet ajrore nisën pa aprovimin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Vendimi për bombardim u ndërмор pas refuzimit të asokohe presidentit të Jugosllavisë, Slllobodan Millosheviq, që të zgjidhej politikisht kriza e Kosovës.

Bombardimet e NATO-s kishin tri objektiva kryesore: mbrojtjen ajrore jugosllave, sistemet e komandës dhe kontrollit dhe forcat ushtarake serbe të dislokuara në Kosovë.

Duke pasur shumë shtete anëtare dhe aeroplanë të shumtë në dispozicion, në një raport të NATO-s të vitit 2000 përmenden tri lloje aeroplanësh që kanë luajtur rol kyç në suksesin e bombardimit të Jugosllavisë. Në fushatën ajrore ishin përdorur edhe dronët.

Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, të hënë ka bërë homazhe te pllaka përkujtimore e ushtarëve

të NATO-s, në përvjetorin e ndërhyrjes së Aleancës më 24 mars 1999.

Me këtë rast, presidentja Osmani ka thënë: “Sot, me nderim dhe mirënjohje, bëme homazhe te pllaka përkujtimore e ushtarëve të NATO-s, në përvjetorin e ndërhyrjes së Aleancës më 24 mars 1999. Ky akt historik i guximit dhe drejtësisë i dha fund regjimit gjenocidal të Serbisë dhe hapi rrugën drejt lirisë së Kosovës. Ushtarët e NATO-s janë heronj të lirisë sonë - ata qëndruan përkrah popullit tonë në ditët më të errëta, siç vazhdojnë edhe sot, ndaj mbeten gjithmonë pjesë e historisë sonë. Lavdi sakrificës së tyre! Mirënjohje e përvjetshme Aleancës për paqen dhe lirinë tonë!”.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka kujtuar sot 26-vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, duke e cilësuar histori suksesi të lirisë dhe demokracisë. “26 vjet më parë bota e lirë i doli zot historisë. Në

një moment vendimtar për popullin tonë, kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe populli ynë po luftonin kundër gjenocidit të pushtuesit serb, NATO ndërhyri në Kosovë”, theksoi Krasniqi.

Ai kujtoi marsin e vitit 1999, kur aleanca më e fuqishme ushtarake ndërhyri për ta ndalur makinerinë serbe të krimin dhe për ta larguar përgjithmonë pushtuesin nga Kosova. “Sot, 26 vjet më pas, Kosova është një shtet i lirë dhe sovran, një histori suksesi e lirisë dhe demokracisë në rajon”, tha ai, duke shprehur mirënjohje për të gjithë ata që kontribuan në këtë arritje historike.

Në këtë përvjetor Krasniqi kujtoi dëshmorët e rënë për liri, duke përçar respektin dhe ngushëllimet për familjet e tyre. “Mirënjohje e përvjetshme NATO-s dhe të gjithë atyre që qëndruan në anën e duhur të historisë. Falë ndërhyrjes së saj, Kosova është e lirë, dhe liria jonë është e përhershme!”, përfundoi ai.



Reshje të mëdha gjatë kësaj jave, paralajmërohen vërshime të shpejta në disa zona të Kosovës

PRISHTINË, 24 MARS - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka njoftuar se gjatë kësaj jave do të ketë reshje të konsiderueshme dhe përmirësim të kushteve agrometeorologjike. "Pas një periudhe të gjatë pa reshje,

java e ardhshme pritet të sjellë një përmirësim të dukshëm të deficitit të reshjeve që ka vazhduar që nga muaji shkurt. Reshjet do të jenë të konsiderueshme, kryesisht në formë shiu në viset e ulëta, ndërsa në zonat malore pritet

që reshjet të shoqërohen edhe me borë", thuhet në njoftimin e IHMK-së.

Kushtet biometeorologjike dhe agrometeorologjike do të jenë në përmirësim gradual. Megjithatë, në disa zona me infrastrukturë të dobët

ekziston mundësia për vërshime të shpejta për shkak të intensitetit të reshjeve. Era do të jetë e pranishme nga drejtimi jugperëndimor dhe verilindor, me shpejtësi mesatare dhe, lokalisht, të fortë.



ÇFARË DIHET DERI TANI PËR VRASJEN E 19-VJEÇARIT NË VUSHTRRI?

VUSHTRRI, 24 MARS - Një djalë 19-vjeçar u vra me armë zjarri nga një djalë tjetër të dielën mbrëma në qytetin verilindor të Kosovës, Vushtrri. I dyshuari është kapur pak kohë pas aktit dhe është dërguar në mbajtje. Ai raportohet se e ka pranuar fajësinë.

Motivet e vrasjes nuk dihen ende, derisa autoritetet thanë se po kryejnë hetime të vazhdueshme.

I dyshuari shtiu me armë zjarri në drejtim të 19-vjeçarit Ardit Zymeri mbrëmjen e së dielës në rrugën "Galip Badivuku" në Vushtrri, duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse, tha Policia e Kosovës të hënën.

Viktima u dërgua në Spitalin e Vushtrrisë, ku nga autoritetet spitalore u konfirmua vdekja e tij, tha policia pas një hetimi fillestar.

Zëdhënësi i Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Valon Preteni, tha për Radion Evropa e Lirë se i dyshuari është ndaluar për 48 orë nën akuzën për vrasje të rëndë.

Preteni shtoi se i dyshuari e



pranoi fajësinë për kryerjen e vrasjes gjatë dhënies së deklaratës.

Policia tha se si prova materiale ka gjetur tri gëzhoja dhe se e ka konfiskuar një revole që dyshohet se është përdorur nga i

dyshuari në kryerjen e vrasjes. "Në shtëpinë e të dyshuarit është realizuar bastisje, ku është gjetur dhe konfiskuar edhe një armë e gjatë me pesë (5) fishekë", tha Policia.

Preteni tha se nuk mund të flasë

për motivet e mundshme të vrasjes dhe se për këtë janë duke u kryer hetime të vazhdueshme. Policia e Kosovës, ndërkohë, tha se është duke i vazhduar hetimet në bashkëveprim me prokurorin e rastit, për t'i zbardhur të gjitha

rrethanat që ndërlidhen me rastin e vrasjes.

Khaxhai i viktimës, Nysret Zymeri, tha për media se familja nuk e njeh dorasin dhe nuk ka pasur telashe me njerëz të tjerë. "Nuk e dimë se si ka ndodhur. Të keqe nuk kemi pasur me askënd. Nuk kemi pasur me njeri të gjallë asnjë fjalë të keqe, ne nuk e kemi pritur... Kjo na ka ndodhur, informatën e kemi marrë mbrëmë, nuk e kemi njohur dorasin, as tani nuk e njohim", ka thënë ai.

Preteni theksoi se prokurori do të kërkojë nga gjykata shqiptimin e masës së paraburgimit për të dyshuarin.

Të hënën është raportuar edhe për dy të vrarë në Vushtrri

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur të hënën afër Vushtrrisë. Sipas burimeve të medieve, një pronar i furrës së bukës dyshohet se ka vrarë punëtorin e tij dhe më pas ka kryer vetëvrasje.

JASHARAJ: MËSIMDHËNËSVE DUHET T'U RRITEN PAGAT



PRISHTINË, 24 MARS - Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, ka thënë se pret formimin e qeverisë së re në mënyrë që të ulen dhe të dialogojnë sa i përket përmirësimit të kushteve të mësimdhënësve. "Pa u krijuar institucionet që kanë dalë nga vota e 9 shkurtit, ne nuk kemi as me kë të komunikojmë. Plani ynë është të presim në mënyrë që institucionet t'i kuptojnë hallet tona. Dëshira jonë është që përmes dialogut të plotësohen kërkesat e punëtorëve të arsimit. Me formimin e qeverisë së re, shpresoj e uroj që t'ia vënë më

shumë veshin sektorit të arsimit sepse mund të shtohen zërat dhe mund të ketë veprime sindikale. Shkumësit e shpuzës i ka kaluar koha. Tash është mundësia që edhe mësimdhënësve t'u krijohen mundësitë që të jenë më të motivuar. Institucionet tona t'i shikojnë shtetet përreth dhe në këtë pikë atyre t'u bëhen kontratat. Të kemi ngritje dukshëm të pagave të vlerës së koeficientit e jo herë 50 në këtë muaj, 50 në tjetrin. Mësimdhënësit duhet të kenë paga më të mira për t'u motivuar" ka thënë Jasharaj në një bisedë

për "IndeksOnline". I pari i SBASHK-ut ka thënë se me qeverinë Kurti nuk kanë kaluar periudhë të mirë. Përkundrazi, siç thotë ai, e shohin si një përvojë të vështirë, andaj uron që qeveria e ardhshme të ketë qasje më ndryshe dhe modeste. "Neve na mbetet të shohim se kush do ta formojë qeverinë, ngaqë kërkesat janë legjitime dhe modeste. Të kemi një marrëveshje kolektive për secilin sektor. Në shkollat tona dukshëm ka mungesë të kushteve dhe në këtë drejtim duhet të punohet", ka vlerësuar Jasharaj.

I jepet lamtumira nënës Fatime Xhemaili

FERIZAJ, 24 MARS - Të hënën në fshatin Komogllavë të Ferizajt, në varrezat e reja të Mëhallës së Tafaliajve, i është dhënë lamtumira nënës së nënës Fatime Xhemaili, një gruaje të jashtëzakonshme, një nëne heroinë, e cila gjithë jetën e saj e jetoj me dashuri për atdheun dhe sakrificë

për lirinë. "Me zemër të pathyeshme dhe shpirt të palodhur, ajo rriti dhe edukoi bijtë dhe bijat e saj - Bajrushin, Mustafën, Emrushin, Qamilin, Mufailin, Nazifen dhe Lumnijen - në frymën e përkushtimit ndaj çështjes kombëtare, duke u bërë

shembull i qëndresës dhe guximit. Amaneti i saj do të mbetet i gjallë në zemrat tona, në rrugën e fëmijëve të saj veprimtarë dhe në kujtesën e përgjeshme të popullit tonë. Lavdi jetës dhe veprës së saj!", ka shkruar në "Facebook" kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi.



Tuberkulozi mbetet një nga sfidat kryesore shëndetësore në botë, as Kosova nuk bën përjashtim

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 MARS - Me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Tuberkulozit, me moton "Po! Ne mund t'i japim fund TB-së: Përkushtim, investim, realizim", Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Shëndetësinë Publike, ka organizuar tryezë të rumbullakët.

Në këtë tryezë kanë marrë pjesë sekretari i përgjithshëm, dr. Naim Bardiqi, drejtoresha e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, dr. Ardita Baraku, kryetari i Shoqatës së Pulmologëve të Kosovës, Skënder Bllacaj, përfaqësues nga institutet regjionale, si dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë.

Në fjalën e tij, sekretari i përgjithshëm, dr. Naim Bardiqi, ka theksuar se sot shënohet një ditë e cila na kujton prioritetin dhe nevojën për ta vazhduar luftën kundër kësaj sëmundjeje. Tuberkulozi mbetet një nga sfidat kryesore

shëndetësore në botë dhe as Kosova nuk bën përjashtim. "Ministria e Shëndetësisë ka investuar në forcimin e kapaciteteve diagnostikuese, trajtimin falas të pacientëve dhe rritjen e vetëdijes për rëndësinë e raportimit dhe diagnostikimit të hershëm. Ministria ka filluar kontraktimet sociale që në vitin 2018 dhe që nga atëherë ka ndarë vazhdimisht mjete për OJQ-të që realizojnë aktivitete avokuese, promovuese dhe edukative në fushën e tuberkulozit (TB). Shuma e ndarë për vitin 2023-2024 për aktivitetet e TB-së është 26,400.00 euro. Gjithashtu, Ministria e Shëndetësisë siguron blerjen e terapive antituberkulare, duke mundësuar që çdo pacient të marrë trajtim bashkëkohor, të pandërprerë dhe falas. Nga viti 2017 e deri më tani, Ministria e Shëndetësisë ka blerë barna antituberkulare në vlerë prej rreth 800 000 euro", tha Bardiqi. Ndërsa drejtoresha e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, dr. Ardita Baraku, ka



theksuar përkushtimin e Institutit Kombëtar në luftën kundër tuberkulozit përmes bashkëpunimit me politikëbërësit, financuesit, profesionistët shëndetësorë, pacientët dhe familjet e tyre, mediet dhe organizatat vendore e ndërkombëtare. Ajo tha se Instituti Kombëtar ka një rol thelbësor në zbatimin e rregullt të vaksinimit,

mbikëqyrjen epidemiologjike, sigurimin e diagnostikës përmes Laboratorit Nacional Referent për tuberkulozin, edukimin dhe promovimin shëndetësor, analizën dhe publikimin e statistikave shëndetësore dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë për Sistemin për Mbikëqyrjen e Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN).

Gjatë kësaj tryeze u bë prezantimi i Situatës Epidemiologjike të TB-së 2024 në Kosovë, aktiviteteve për promovim dhe edukim të popullatës kundër TB-së, angazhimit të Ministrisë së Shëndetësisë në luftën kundër TB dhe zhvillimin dhe funksionalizimin e SMSN-së/Moduli i TB-së në sistemin e informimit shëndetësor.

Kosova vlerësohet rrëfim i rrallë dhe i jashtëzakonshëm me Bankën Botërore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 MARS - Të hënën është mbajtur në Prishtinë konferenca e përbashkët për medie nga ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, dhe zëvendës-presidenti i Bankës Botërore për Financimin e Zhvillimit, Akihiko Nishio.

Ministri Murati vlerësoi lart rolin e Bankës Botërore dhe të Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim (International Development Association - IDA) si një partner crucial në zhvillimin gjithëpërfshirës të Republikës së Kosovës. Sipas tij, IDA - si krahu zhvillimor i Bankës Botërore për më shumë se 15 vjet - ka mbështetur vendin tonë me projekte



zhvillimore me kushte jashtëzakonisht të favorshme. Ministri Murati ka bërë me dije se deri më tani janë nënshkruar dhe ratifikuar marrëveshje në vlerë prej 376 milionë eurosh, ndërsa 289 milionë euro janë

disbursuar. Këto projekte përfshijnë sektorë jetikë si tregtia dhe transporti, sistemi shëndetësor, edukimi i hershëm, zhvillimi i sektorit financiar, si dhe mbështetja për themelimin e Bankës

Zhvillimore të Kosovës.

Murati, gjithashtu, nënvizoi faktin se Kosova, për herë të parë, ka marrë pjesë si shtet donator në mbledhjen e fundit për rimbushjen e fondit të IDA-s, duke shënuar kështu një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të shtetësisë dhe të imazhit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës.

Nga ana tjetër, zëvendës-presidenti i Bankës Botërore për Financimin e Zhvillimit, Akihiko Nishio, e vlerësoi lart përkushtimin e Kosovës për ofrimin e ndihmës ndaj shteteve të tjera dhe për zhvillimin ekonomik, veçmas në kohën e krizës globale. Ai shtoi se Kosova zë vendin si donatore në IDA-21 (Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim), duke përmbyllur kështu një

cikël të plotë në rrugëtimin e saj të zhvillimit. Sipas tij, vendimi i Kosovës për të kontribuar në IDA-21 fuqizon objektivat e përbashkëta: zhdukjen e varfërisë dhe ndërtimin e shoqërive të barabarta. "Vite më parë Kosova qëndronte mes shteteve që rindërtoheshin nga vështirësitë, duke shfrytëzuar mbështetjen e IDA-s për t'i hedhur themelet e rritjes. Sot ju i keni shndërruar sfidat në mundësi, duke u shfaqur si një partner i gatshëm për ta shtrirë dorën e ndihmës edhe për të tjerët. Ky kalim nga përfitues në kontribuues është një rrëfim i rrallë dhe i jashtëzakonshëm, i cili flet për qëndrueshmërinë, vizionin dhe përkushtimin e palëkundur të Kosovës ndaj progresit", ka theksuar Nishio.

Formimi i qeverisë, Murati: Po presim certifikimin e rezultateve

PRISHTINË, 24 MARS - Ministri në detyrë i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka deklaruar se po presin përfundimin e procesit të numërimit të votave, certifikimin e rezultateve, më pas të diskutohet për formimin e qeverisë. Këtë deklaratë e bëri pas konferencës së përbashkët me zëvendës-presidentin e Bankës Botërore për Financimin e Zhvillimit, Akihiko Nishio. "Në lidhje me këtë çështje po besoj

vlen ajo çfarë ka thënë kryeministri. Pra, fillimisht do ta presim përfundimin e procesit të numërimit, certifikimin e rezultateve, konstituimin e Kuvendit, pastaj edhe mund të flasim për formimin e qeverisë", tha Murati.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë e ka miratuar rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit. Sipas këtyre rezultateve, Lëvizja Vetëvendosje prin me 42.30 për

qind. E dyta Partia Demokratike e Kosovës me 20.95 për qind, pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 18.27 për qind. Në vendin e katërt është koalicioni në mes të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate me 7.06 për qind. Sipas këtyre të dhënave, LV-ja ka siguruar 48 ulëse në Kuvendin e Kosovës, PDK-ja, 24 ulëse, LDK-ja, 20 vende, Lista Serbe nëntë vende dhe koalicioni AAK-Nisma, tetë vende.



Oda Ekonomike Amerikane rekomandon zgjatjen e afatit për liberalizimin e tregut të energjisë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 MARS - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë u kërkon politikë-bërësve ta rishqyrtojnë liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, të planifikuar për vitin 2025, kjo pasi Oda Amerikane mbështet plotësisht një treg të hapur dhe konkurrues të energjisë dhe vlerëson se kushtet aktuale tregojnë se Kosova ende nuk është e përgatitur për këtë tranzicion. “Pavarësisht prej ekzistencës së 19 furnizuesve të licencuar, vetëm një është aktualisht funksional, duke krijuar një pozicion monopolist de facto që kufizon konkurrencën”. Oda Amerikane sqaron se bizneset janë thellësisht të shqetësuara për rritjen e kostove të energjisë, me 80 % të kompanive të anketuara që presin rritje të konsiderueshme të kostove që do të ndikojnë drejtpërdrejt në konkurrencën e tyre. “Ndryshe nga homologët rajonalë, Kosova nuk ka siguruar konkurrencë të mjaftueshme me furnizuesit përpara se ta zbatojë liberalizimin e tregut, duke i lënë bizneset me opsione të kufizuara dhe pasiguri të shtuar. Për më tepër, afati i

shkurtër kohor i zbatimit - i paraprirë nga fushata të paqarta informacioni - nuk i lejon bizneset të përgatiten në mënyrë adekuate. Për qëllime buxhetore, hyrja në një rritje të kostos në mes të vitit shtrembëron planifikimin dhe menaxhimin financiar, gjë që mund ta destabilizojë vazhdimësinë operacionale”, thuhet në njoftimin e Odës Ekonomike Amerikane. Pasiguria e investimeve sipas Odës Ekonomike Amerikane është një tjetër çështje urgjente, pasi 70 % e kompanive kanë frikë se rritja e kostove të energjisë do të ndikojë negativisht në planet e tyre afatgjatë të investimeve dhe zgjerimit. “Ndërsa investimi në energjinë e rinovueshme njihet gjerësisht si një zgjidhje potenciale afatgjatë, bizneset pranojnë se investime të tilla kërkojnë kohë dhe nuk mund të zbatohen para 1 qershorit 2025”. Oda Amerikane tregon se gjetjet nga diskutimet dhe anketat e biznesit nxjerrin në pah shqetësimet kryesore. “Shumë biznese raportojnë mungesë informacioni në lidhje me furnitorët e disponueshëm dhe procesin e tranzicionit, duke e bërë të vështirë marrjen e vendimeve të informuara. Një strategji komunikimi më e fortë




dhe më transparente është e nevojshme për të mbështetur bizneset gjatë këtij tranzicioni. Për më tepër, shumica e bizneseve ndihen të papërgatitur për të vlerësuar dhe negociuar kontratat në një treg të liberalizuar, duke ngritur shqetësime për aftësinë e tyre për të siguruar marrëveshje të drejta dhe konkurruese”. Për të mbështetur një tranzicion më të qëndrueshëm dhe efektiv, Oda Amerikane rekomandon që qeveria ta miratojë legjislacionin e nevojshëm dytësor për t'i zhblokuar investimet në sistemet e ruajtjes së baterive - kritike për fleksibilitetin e rrjetit dhe menaxhimin efikas të energjisë. Në të njëjtën kohë, duhet të futet një skemë e re tatimore dhe doganore për t'i inkurajuar investimet në

teknologjitë me efikasitet energjetik. Oda Amerikane, gjithashtu, i kërkon fuqimisht qeverisë që ta iniciojë zhvillimin e një njësie gjeneruese vendore me kapacitet të madh, e cila do ta rriste ndjeshëm pavarësinë energjetike të Kosovës dhe sigurinë e furnizimit. “Oda Amerikane mbetet e përkushtuar për të mbështetur tranzicionin energjetik të Kosovës dhe do të kontribuojë duke edukuar anëtarët e saj dhe komunitetin e gjerë të biznesit për përfitimet e rritjes së investimeve në eficiencën e energjisë”. Duke pasur parasysh këto sfida, Oda Ekonomike Amerikane rekomandon fuqimisht që politikëbërësit ta shtyjnë liberalizimin e tregut derisa të paktën tre furnizues të jenë

plotësisht funksionalë për të siguruar konkurrencë të vërtetë. “Duhet të krijohet një plan i qartë komunikimi për t'i ofruar bizneseve informacionin e nevojshëm në lidhje me opsionet e furnitorëve dhe negociatat e kontratave. Për më tepër, duhet të futen mekanizma të stabilitetit të çmimeve për të mbrojtur bizneset nga rritjet e papritura të kostove. Zgjatja e afatit të tranzicionit përtej 1 qershorit 2025, është thelbësore për t'u dhënë bizneseve kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur me strukturën e re të tregut. Duhet të zbatohen gjithashtu politika për të inkurajuar konkurrencën e furnizuesve dhe për të mbështetur hyrjet e reja në treg, duke nxitur një treg vërtet konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë”. Kjo odë vlerëson se liberalizimi i tregut energjetik të Kosovës në kushtet aktuale do të dëmtojë bizneset, do ta ulë konkurrencën dhe do t'i dekurajojë investimet. Oda Amerikane u bënë thirrje politikëbërësve të miratojnë një qasje strategjike, me faza që i jep përparësi konkurrencës së tregut, stabilitetit të çmimeve dhe gatishmërisë së biznesit për të siguruar një tranzicion të suksesshëm.

Fusha e Departamentit të Operimeve, një hap më afër aftësimit të plotë për nxënësit në KEDS Academy



PRISHTINË, 24 MARS - Aftësimi profesional i nxënësve të KEDS Academy 12 tashmë ka kaluar në një tjetër dimension. Në kuadër të programit tonë edukativ, KEDS Academy, nxënësit e shkollave profesionale mësuam mbi operimet e KEDS-it nga vetë ekspertët e Departamentit të Operimeve. Kjo ligjëratë, përveçse një leksion teorik e praktik, do t'u shërbejë në përvojat e tyre përgjatë rugëtimit profesional. Nxënësit, ndër të tjera, mësuam edhe për njehsorët dhe matjet e energjisë - llojet e njehsorëve,

matjen e saktë të konsumit dhe rolin e tyre në menaxhimin e energjisë; Leximin dhe faturimin-procedurat e leximit të njehsorëve, faturimin korrekt dhe adresimin e ankesave të konsumatorëve; Shkycjen dhe rikycjen e konsumatorëve-arsyet e shkycjes, mënyrat e realizimit të procesit dhe hapat e sigurisë që duhen ndjekur; Ndërrimin dhe zhvendosjen e njehsorëve-përdorimin e pajisjeve më të avancuara e të sigurta për menaxhimin efikas të ndërrimit të njehsorëve; Pajisjet dhe teknologjinë-njohjen me pajisjet

moderne, si Hand Held Unit dhe M3, për lexim të saktë të konsumit. Sipas KEDS-it, kjo qasje proaktive dhe praktike i pajis nxënësit jo vetëm me njohuri reale mbi fushën e energjetikës, por edhe i bën të gatshëm për tregun e punës. Përmes investimit në KEDS Academy, KEDS-i po investon në edukimin e nxënësve e studentëve, duke ndihmuar në krijimin e brezave të rinj profesionistësh - të gatshëm të kontribuojnë në sektorin e energjisë.

Hiqet bllokada e shkaktuar nga Ligji për Pronën Publike

PRISHTINË, 24 MARS - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DhTIK) i ka njoftuar kompanitë anëtare se pas një pune të gjatë është arritur të hiqet bllokada e shkaktuar nga hyrja në fuqi e Ligjit për Pronën Publike, nga i cili kanë humbur shumë numër i madh i bizneseve. Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë ka theksuar

se i njëjti ligj ka pamundësuar edhe realizim të investimeve në disa sektorë, përfshirë edhe në atë të energjisë së pastër, për të cilën vendi ka shumë nevojë. “Ne kemi dhënë komentet tona në grupin punues për tri rregulloret që do të mundësonin nisjen e punës së Zyrës për Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e

Kryeministrit. Rregulloret janë publikuar në Gazetën Zyrtare, që shënon zyrtarisht nisjen e punës së kësaj zyre”, ka njoftuar DhTIK. DhTIK është në pritje të aranzhimit të një takimi me drejtuesit e zyrës së lartpërmendur dhe se do ta vazhdojë angazhimin e saj në zgjidhjen e problemeve të bizneseve anëtare.



DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRIËS KOSOVË
CHAMBER OF TRADE AND INDUSTRY KOSOVA

‘TRUMPI DUKET I DASHURUAR ME PUTININ. EVROPA KA NJË ZË, NË 1945-ën NUK KISHTE!’

Eseja e tij “Për luftën” është botuar 30 vjet më parë, por së fundmi ka parë një rritje të menjëhershme të shitjeve. Michael Walzer – intelektual dhe filozof politik, profesor emeritus në Universitetin Princeton – mbetet ende një nga zërat që na ndihmojnë më së miri të kuptojmë të tashmen, sidomos sot në dritën e konfliktit në Ukrainë dhe pasojave të tij mbi rendin botëror.

«Lufta ruse është një sulm i paprovokuar ndaj një fqinji, një shteti të pavarur dhe sovran. Është qartazi e paligjshme. Është gjithashtu – dhe kjo është edhe më e rëndësishme – e padrejtë: është një krim jo vetëm ligjërisht, por edhe moralisht», shkruante ai në vitin 2022.

Pyetja është nëse kjo mbetet e vërtetë edhe sot, duke pasur parasysh se në përkufizimin e një lufte të drejtë përfshihet edhe një «mundësi e arsyeshme për sukses», për të mos rënë në atë që R.R. Reno e quan “krenaria pagane”, ndryshe nga gjykimi moral kristian.

A mund të flitet ende për një luftë të drejtë, kur tashmë duket e qartë se Ukraina nuk ka mundësi për të fituar? Duhet ndoshta të flasim për paqe të drejtë ose të padrejtë?

«Vendimi se sa gjatë të luftohet dhe çfarë pozicioni të merret në negociatë duhet të jetë vendim i qeverisë ukrainase. Aktualisht, duket se qeveria amerikane është e nxituar për t'i dhënë formë një paqeje mes Ukrainës dhe Rusisë pa u konsultuar me ukrainasit. Zgjedhja se çfarë të bëjnë është shumë e vështirë për Ukrainën, por mbetet gjithsesi një zgjedhje e tyre. Pas braktisjes nga ana e Amerikës, ajo që u nevojitet është një mbështetje shumë e fortë nga Evropa, por nuk jam i sigurt sa e përgatitur është Evropa për ta ofruar këtë.» Mendoni se vështirësitë që ka pasur dhe po ka Evropa për të mbështetur Ukrainën janë më shumë ideologjike, politike apo ekonomike?

«Keni të drejtë, ka edhe një aspekt ekonomik që unë tentoj ta nënvlerësoj. Mbrojtja e sovranitetit dhe demokracisë së Ukrainës duhet të jetë një angazhim moral, dhe tani ky angazhim duhet të përkthehet në ndihmë për të arritur një paqe sa më të mirë, një marrëveshje më të mirë se ajo që amerikanët mund të arrijnë nëse lihen të negociojnë vetëm me rusët. Trump duket i dashuruar me Putinin. Vetëm Zoti e di çfarë ndodhi në ato dy orë telefonatë. Thelbi është se ka realisht nevojë për një ndërhyrje shumë të fortë nga Evropa, dhe shpresoj që kjo të çojë drejt një negociate më të favorshme. Jemi të gjithë dakord që duhet gjetur një rrugëdalje



nga lufta, por ajo rrugë nuk duhet të jetë në kurriz të Ukrainës.”

Citoj fjalët tuaja: “Pavarësia nuk është një vlerë që mund të shkëmbehet lehtësisht.”

«Shumë vende fqinje me Ukrainën janë të shqetësuara për pavarësinë e tyre. Në këtë moment, angazhimi për ta ndihmuar Ukrainën përfaqëson përpjekjen për të refuzuar një rikthim në Jaltë.»

Rikthimi te sferat e influencës që Trump i pëlqen aq shumë.

«Dhe është edhe qëndrimi i të ashtuquajturve “realistë”, ata që i atribuojnë pushtimin e vitit 2022 zgjerimit të NATO-s në atë që duhej të ishte sfera ruse, të cilës Ukraina – sipas tyre – i përkiste. Në Jaltë ne u dhamë rusëve atë që shumë realistë sot thonë se duhet t’u japim sërish: një sferë influence në Evropën Lindore, gjë që çoi në qeveri të tmerrshme dhe, në fund, në revolta e kryengritje. Dhe nuk duhet ta bëjmë këtë sërish. Realistët e urrejnë “moralizmin”, por megjithatë këmbëngulin se argumenti i tyre për sferat e influencës bazohet te rëndësia e paqes ndërkombëtare – që gjithsesi është një argument moral. Propozimi i tyre është që fuqive të mëdha, në emër të paqes, t’u lejohet të ruajnë sfera influence, që shpesh përkthehen

në kontroll politik përtej kufijve të tyre. Rendi botëror arrihet përmes ndarjes së botës mes fuqive të mëdha. Për aq sa mund të ketë qenë e nevojshme, marrëveshja e Jaltës jep një shembull të gjallë të çmimit që kërkon realizmi. Popujt e Evropës Lindore paguan atë çmim në formën e brutalitetit, korrupsionit dhe paaftësisë së regjimeve autoritare që sovjetikët krijuan në sferën e tyre.»

Çfarë përshtypje ju bën sot, në vitin 2025, të flitet sërish për ndarjen e botës sipas konferencës së Jaltës? Pse po kthehemi mbrapa në vend që të ecim përpara?

«Dallimi është se tani Evropa ka një zë, në vitin 1945 nuk e kishte. E djathta ka besuar gjithmonë te sferat e influencës, dhe Trump – natyrisht – beson se sfera e ndikimit amerikan duhet të përfshijë Kanadanë, Meksikën, Amerikën Qendrore dhe Groenlandën (qesh).»

Si e interpretoni këtë fiksim të Trump për ta bërë Kanadanë shtetin e 51-të amerikan?

«Kanadezët janë mjaft të fortë, por ajo që është me të vërtetë e habitshme është se, nëse Kanada do të bëhej pjesë e Shteteve të Bashkuara, republikanët nuk do të fitonin më kurrë zgjedhje. Duke lënë

shakatë mënjane, nuk e kuptoj çfarë po bën Trumpi, cilat janë qëllimet e tij të vërteta.»

A mendoni se me qasjen e tij si biznesmen, Trump u ofron ndonjë avantazh amerikanëve në negociatat me vendet e tjera?

«Nuk mendoj se Trump është ndonjë biznesmen i madh. Mendoj se ai po shfrytëzon maksimalisht pushtetin e presidencës. Dhe kjo më shqetëson. Vetëm për të mos humbur fondet federale, Universiteti Columbia ka pranuar kërkesat e Trump-it: do të ndalojë përdorimin e maskave gjatë protestave, do të disiplinojë protestuesit, do të reformojë pranimin në universitet; disa firma juridike praktikisht janë dorëzuar dhe nuk përfaqësojnë më kundërshtarët e tij; e gjithë Partia Republikane po zvarritet përpara tij. Kjo nuk është aftësi për të bërë marrëveshje, por një ushtrim shumë i guximshëm i pushtetit ekzekutiv. Dhe mendoj se rezultati do të jetë një kundërshti e fortë, dhe se demokratët do ta rimarrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve për një vit e gjysmë.»

Deri më sot, pak ose aspak e ka dëmtuar politikisht. A ekziston një kufi përtej të cilit edhe ndjekësit e tij mund të

rebelohen kundër tij? Nëse po, cili është?

«Gjërat e turpshme që po bën në lidhje me emigracionin nuk kanë ndikuar në sondazhe, por çmimet e larta po, dhe ndoshta edhe sulmet ndaj gjykatave janë një temë tjetër ku shpresoj të përballlet me një kundërshtim të fortë. Mendoj edhe për një situatë ku humbin jetë njerëzish – edhe në atë rast mund të ndikohet. Jam i bindur se një e treta e vendit do të qëndrojë gjithmonë me të, por në zgjedhjet e fundit pati shumë njerëz që votuan për të, për arsye shumë afatshkurtra. Po vuanin ekonomikisht dhe mendonin se Trump do të bënte diçka që Biden nuk e kishte bërë, ose nuk kishte mundësi ta bënte.»

A mund të ndryshojë Trump me të vërtetë fibrën morale të Amerikës – nëse nuk e ka bërë tashmë?

«Nuk mendoj se do t’ia dalë. Unë pres që të shfaqet një rezistencë e fortë, që për momentin mungon. E majta po kërkon një lider. Nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një Lider me “L” të madhe, mjafton një njeri me bindje. Ka disa demokratë që premtojnë – mendoj për shembull për senatorin Chris Murphy nga Connecticut.»

I vetmi që duket se po bën diçka është Bernie Sanders.

«Për momentin, duket se u takon të moshuarve të shpëtojnë vendin (qesh). Kam nipër që sapo kanë përfunduar universitetin dhe po kërkojnë punë, pa gjetur dot. Ajo që dua të them është se ka arsye ekonomike për të pritur ringjalljen e një lloj demokracie sociale ekonomike mes të rinjve. Mendoj se, duan apo jo, duke parë si qëndrojnë gjërat në aspektin e pabarazisë, brezat më të rinj do të shtyhen në atë drejtim.»

A është ende gjallë ideja e një tregu të lirë dhe e një shoqërie globale, apo po i nënshtrohet një ndjenjë më nacionaliste – si në Evropë, ashtu edhe në SHBA?

«Përballë një ekonomie globale, një përgjigje në sens nacionalist është reale, dhe ishte e parashikueshme. Mbrojtja e zakoneve lokale, e historive lokale, është diçka në të cilën kam besuar gjithmonë. Unë e përkufizoj veten si ‘komunitar’, sepse mendoj se komunitetet lokale janë të rëndësishme dhe se ka njerëz – si në të majtën globale, veçanërisht atë neolibérale globaliste – që nuk kanë aspak ndjeshmëri për ndjenjat e zakonshme të përkatësisë komunitare që kanë njerëzit.» / La Stampa – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Agjenti i Zhegrovës: Ja pse dështoi transferimi te Napoli

Agjenti i Edon Zhegrovës, për ‘Stile TV’, ka treguar arsyen pse ka dështuar transferimi i yllit të Kosovës te Napoli. Reprezentuesi i Kosovës prej kohësh ishte cak i kontakte me Napolin. Ata nuk përfundoi mirë”, ka thënë agentin i Zhegrovës, Sergio Mezi. “Tashmë e shoh të vështirë transferimin te Napoli. Na ka ardhur edhe një ofertë nga Barcelona. Në nëntor u takuam sërish, por drejtuesit e Lilles nuk donin që të hiqnin dorë nga Zhegrova dhe ta shisnin atë”, ka theksuar agjenti i Zhegrovës.

Foda: Isha i bindur se do të ngjiteshim në Ligën B



“Epoka e re”

PRISHTINË, 24 MARS - Përzgjedhësi i Kosovës në Futboll, Franco Foda, ka thënë se ishte i bindur se “dardanët” do të arrinin suksesin për t’u promovuar në Ligën B. Kosova të dielën në Murcia e mposhti Islandën në ndeshjen kthyesë (1-3) dhe e siguroi kalimin historik në Ligën B, që është niveli i dytë i Ligës së Kombeve. Strategu gjerman është shprehur krenar për ekipin e tij. “Ky ishte qëllimi ynë. Qëllimi i parë ishte të ngjiteshim në Ligën B, nga Liga B e më tej. Jam shumë, shumë krenar për ekipin. E dinim që kundërshtari ishte një ekip shumë, shumë i mirë. Por unë isha i bindur se ne ishim në gjendje të ngjiteshim në Ligën B. E dominuam ndeshjen. Luajtëm jashtëzakonisht mirë në sulm. Ishim shumë të mirë edhe në lojën pa top dhe shihet qartë që ekipi është zhvilluar shumë mirë gjatë javës dhe muajve të fundit.

Tani duhet thjesht të vazhdojmë përpara dhe ta marrim këtë shpirt ekipi edhe në muajin qershor”, ka thënë Foda, në një video të publikuar nga Federata e Futbollit të Kosovës. Pas suksesit historik ka folur edhe futbollisti Vedat Muriqi, i cili realizoi tre golat për Kosovën. Ai ka thënë se tash Kosova ka treguar se është arrë e fortë për çdo kundërshtar. “Jam shumë i kënaqur që kemi bërë një arritje të jashtëzakonshme si kombëtare. Një sulmues nuk mund të ketë një lojë më të mirë se kjo, 3 gola dhe kualifikim në Ligën B. Jam shumë i lumtur, nuk duhet të ndalemi më kaq. I kemi treguar Evropës se jemi bërë një arrë e fortë për kundërshtarin. Do ta vazhdojmë punën tonë, me shpirtin luftarak, pasi kjo besoj është arma jonë dhe do të vazhdojmë të luftojmë pa marrë parasysht. Tani i kemi ndeshjet miqësore në qershor, pastaj na vijnë kundërshtarë edhe më të fortë sesa Islanda”, ka deklaruar Muriqi.

Ambasadori Rohde i gëzohet suksesit historik të Kosovës

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll e ka arritur një sukses historik. “Dardanët” tashmë edhe zyrtarisht janë pjesë e Ligës B të Kombeve. Të dielën ekipi i udhëhequr nga Franco Foda e mposhti Islandën me rezultat 1:3 me Hat-trickun e Vedat Muriqit, derisa rezultati i përgjithshëm nga të dyja ndeshjet, është 5:2 në favor të “verdhekalterve”. Këtij suksesi iu gëzua edhe ambasadori i Gjermanisë në vendin tonë, Jorn Rohde. Ai lavdëroi punën e bashkëkombësit të tij në krye të shtabit teknik të Kosovës. “Kjo tregon fuqinë e punës në grup dhe punës së palodhur”, deklaroi diplomati gjerman. “Bravo, skuadrës së Kosovës – ja ku kemi më shumë fitore përpara”. Rohde si ish-futbollist deklaroi se është frymëzuese të shohësh se çka ka arritur të bëjë Kosova.

SHKURT

Bislimaj përfaqëson Kosovën në Kampionatin Evropian të Golfit

Azer Bislimaj zyrtarisht do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në Kampionatin Evropian të Seniorëve i cili organizohet nga European Golf Association. Ky Kampionat mbahet në Cornelia Golf Club, Belek të Turqisë gjatë muajit qershor. Azeri është i vetmi lojtari senior nga Kosova (50 +) me hcp 1.4 i cili arrin të kualifikohet për këtë Kampionat Evropian dhe do të bëhet lojtari i parë nga Kosova i cili do të paraqitet zyrtarisht me një garë evropiane të EGA-s.

Besa Famgas u rikthehet fitoreve

Besa Famgas është kthyer te fitorja në Superligën e Kosovës në Hendboll. Pas humbjes nga Rahoveci, skuadra pejane të dielën mposhti Prishtinën në kuadër të xhiros së 23-të. Ndeshja në Pejë përfundoi me fitoren 44:32 të Besa Famgasit. Vladimir Stanković udhëhoqi Besën me 12 gola. Dhjetë i realizoi Balsha Çejović, tetë Jon Vokshi e shtatë Olsi Mulaj. Te Prishtina më efikas ishte Oltion Beshiri me dhjetë gola. Gjashtë i shtoi Enis Kuleta e katër Albi Gjuka. Besa Famgas është e dyta me 36 pikë, sa i ka edhe Kastrioti në vendin e tretë. Prishtina është e katërta me 23 pikë. Dy ndeshje të tjera të xhiros së 23-të u zhvilluan të shtunën.

Zelanda e Re kualifikohet në Botëror

Zelanda e Re e ka siguruar kualifikimin në Kampionatin Botëror të Futbollit që mbahet vitin tjetër. Në finale të kualifikimeve të Oqeanisë, Zelanda e Re të hënën e mposhti Kaledoninë e Re me rezultatin 3:0. Ndeshja u zhvillua në Zelandë të Re para 25 mijë shikuesve. Në gjysmëfinale të kualifikimeve, Zelanda e Re fitoi 7:0 ndaj Fixhit, ndërsa Kaledonia e Re mposhti Tahitin me rezultatin 3:0. Për herë të parë Oqeania ka pasur një vend të rezervuar në kualifikimet për Botëror. Kualifikimet në Oqeani nisën në shtator të vitit të kaluar. Vetëm edhe Japonia e ka siguruar kualifikimin. Kanadaja, Meksika dhe ShBA-ja kualifikohen si nikoqire.

Rasid Mahalbasiq, MPV i javës në Superligë

PRISHTINË, 24 MARS - Sigal Prishtina shënoi një fitore të rëndësishme në derbi ndaj Trepçës. Pas kësaj ndeshjeje, të dy skuadrat u barazuan me pikë në tabelë. Lojtarët më të dalluar të sfidës ishin Rasid Mahalbasiq me 18 pikë, 9 kërcime dhe 5 asistime, si dhe Josh Nzeakor, i cili kontribuoi me 19 pikë, 6 kërcime dhe 2

asistime. Golden Eagle Ylli vazhdoi serinë e fitoreve, duke regjistruar të tretën radhazi kundër Pejës. Lojtari më i spikatur i ndeshjes ishte Tulio Da Silva, i cili realizoi 19 pikë, 13 kërcime dhe 1 asistim, duke pasur indeksin më të lartë të sfidës. Bashkimi triumfoi ndaj Borës në “Sezai Surroi” pas një ndeshjeje të

ekuilibruar, ku Mack Smith udhëhoqi ekipin me 18 pikë, 9 kërcime dhe 4 asistime. Vëllaznimi u rikthye te fitorja pas një përballje të vështirë ndaj Proton Cable Prizrenit. Më i dalluari i ndeshjes ishte Atik Koshi me 21 pikë, 7 kërcime dhe 1 asistim, duke qenë vendimtar për suksesin e skuadrës së tij.



Thunder merr fitore të madhe në udhëtim te clippersat

LOS ANXHELOS, 24 MARS - Është zhvilluar xhироja e radhës në elitën e basketbollit amerikan NBA, në të cilën nuk kanë munguar befasitë, por edhe ndeshjet spektakolare. Vëmendja më e madhe ka qenë në Kaliforni, ku Los

Angeles Clippers ishte nikoqir i Oklahoma City Thunderit me mysafirët që morën fitore të ngushtë 101-103. Më meritori për fitoren e mysafirëve ishte ylli kanadez Shai Gilgeous-Alexander që e mbylli ndeshjen me 26 pikë,

tre kërcime e tetë asistime. Paraqitje të mirë pati edhe bashkëkombësi i tij Andrew Wiggins që e përfundoi sfidën me 19 pikë. Te vendasit më efikasi ishte Kawhi Leonard me 25 pikë, por që në fund nuk mjaftuan për fitore.

REZULTATET

Detroit - New Orleans	136-130
Utah - Cleveland	91-120
Atlanta - Philadelphia	132-119
Toronto - San Antonio	89-123
Portland - Boston	116-129
Houston - Denver	111-116
LA Clippers - Oklahoma C.	101-103



Dukagjini triumfon bindshëm, Llapi dhe Mitrovica shënojnë fitore në udhëtim

PRISHTINË, 24 MARS - Xhироja e 14-t e Superligës së Femrave solli përballje të forta dhe shumë gola, me Dukagjinin që shënoi fitoren më të thellë të javës me rezultat 7:2 ndaj Malishevës. Vendaset ishin dominuese gjatë gjithë takimit, duke shënuar tre gola në pjesën e parë dhe duke vazhduar me një performancë të shkëlqyer edhe në fraksionin e dytë të lojës. Ishin mysafirët ato që kaluan të parat në epërsi me një gol të shpejtë të Fortesa Berishës në minutën e 10. Megjithatë, Dukagjini reagoi shpejt dhe barazoi me golin e parë të Erblina Berishaj në minutën e 26. Më pas, Melisa Berisha e kaloi Malishevën në epërsi në minutën e 30, por pas katër minutash Aurona Racaj u kundërpërgjigj me golin e saj duke barazuar rezultatin në 2:2. Pak para se të përfundonte pjesa e parë, Anjeza Berisha shënoi golin e tretë të Dukagjinit, duke bërë që rezultati në pushim të ishte 3:2 për vendasët. Në fraksionin e dytë, Dukagjini dominoi plotësisht me Erblina Berishaj, e cila kompletoi



“hattrick”-un me golat e minutave (46’ e 56’) dhe çoi rezultatin në 5:2, ndërsa Anjeza Berisha shënoi golin e saj të dytë në minutën e 74-t, para se Ylberina Berishaj ta vuloste fitoren 7:2 me një gol në minutën e 87. Nga ana tjetër, ndonëse ishte në udhëtim, Llapi shënoi fitore ndaj Kosova VR, me rezultat 2:1. Në këtë përballje, vendasët kaluan të parat në avantazh me një gol të Donesa Bajramit në minutën e 22-të, por mysafirët reaguan duke e rikthyer lojën në favorin e tyre, kështu që në minutën e 44-t, Lutfie Behrami barazoi

rezultatit. Një minutë më vonë, përkatësisht në minutën e 45-të, Egzona Gashi realizoi golin e dytë, duke siguruar tri pikë. Ndërkohë, takimi në mes të Ulbianës dhe Mitrovicës përfundoi me rezultat 0:2. Ishin sërish mysafirët ato që dominuan lojën. Blerta Shala kaloi Mitrovicën në epërsi në minutën e 29 pas një aksioni të rrjedhshëm, ndërsa Shkurta Maliqi dyfishoi rezultatin pak para përfundimit të pjesës së parë. Pjesa e dytë nuk solli ndryshime në rezultat dhe takimi u përmbyll me rezultat 0:2.

Ferrari pas shkualifikimit të Hamiltonit dhe Leclercit: Gabimi ynë

MARANELLO, 24 MARS - Charles Leclerc dhe Lewis Hamiltoni janë shkualifikuar pas përfundimit të garës së Kinës në Formula 1, të cilën e përfunduan respektivisht në vendin e 5-të dhe të 6-të. Ferrari i Leclercit, i peshuar pas garës, u zbulua se ishte 1 kg nën peshën e lejuar, ndaj shkualifikimi ishte i pashmangshëm. Lewis Hamiltoni u shkualifikua për shkak të konsumit të tepërt të pjesës fundore të makinës. Ajo kishte një trashësi minimale prej më pak se 9 mm në fund të garës. Matja tregoi se ajo ishte 8.6 mm ana e majtë, 8.6 mm vija qendrore dhe 8.5 mm ana e djathtë. Kjo solli shkualifikimin e britanikut. Më pas erdhi deklarata e Ferrarit: “Strategjia e Charles ishte vendosur në një ndalesë të vetme dhe konsumi i tij i gomave ishte shumë i lartë. Kjo është arsyeja pse makina ishte nën peshë. Sa



për Lewisin, ne e vlerësuar gabim konsumin. Nuk kishte asnjë qëllim për të fituar ndonjë avantazh”. “Ne do të mësojmë nga ajo që ndodhi për të mos përsëritur këto gabime. Kjo nuk

është mënyra se si ne donim të përfundonte fundjava jonë e garës në Kinë, as për ne dhe as për tifozët tanë, mbështetja e të cilëve është e palëkundur”, thuhet në komunikatë.

SHKURT

Jahja e Xhema drejtuan ndeshjen çerekfinale në Kupën Evropiane

Gjyqtarët e Federatës së Hendbollit të Kosovës, Besfort Jahja e Sherif Xhema, kanë drejtuar tjetër ndeshje të rëndësishme evropiane në fundjavën e kaluar. Jahja e Xhema ishin të deleguar nga Federata Evropiane e Hendbollit për ta drejtuar takimin Olympiacos-Runar Sanderfjord, që ishte i pari i fazës çerekfinale të Kupës Evropiane për hendbollistë. Ndeshjen e zhvilluar të dielën në Greqi e fitoi Olympacosi me rezultat 37:31. Ndeshja e kthimit është më 30 mars në Sanderfjord të Norvegjisë. FHK-ja paraqitet vazhdimisht me gjyqtarë dhe delegatë në garat evropiane. Drejtimi i ndeshjes çerekfinale nga Jahja e Xhema dëshmon që besimi dhe vlerësimi ndaj zyrtarëve kosovarë të ndeshjeve sa shkon e rritet në EHF.

Kane mendon të rikthehet në Premierë Ligë

Një rikthim në Premierë Ligë do të ishte sensacional. Kjo pritet të ndodhë me Harry Kanen gjatë kësaj vere. Qendërsulmuesi anglez mbërriti në Bayern Munchen verën e kaluar për 120 milionë eurosh të ndarë mes një pjesë fikse (100 milionë) dhe shpërblimeve (20), por dy vjet më vonë ai mund të kthehet në atdheun e tij. Për momentin këto janë vetëm thashetheme, me tregun e transferimeve ende shumë larg dhe bavarezët ende luftojnë në disa fronte. Skuadra gjermane është në rrugën e duhur për ta fituar Bundesligën, ndërkohë që në Ligën e Kampionëve do të sfidojë Interin në çerekfinale. Sipas “Fichajes”, qendërsulmuesi anglez 31-vjeçar po mendon të rikthehet në Premierë Ligë me Liverpoolin që thuhet se është shumë i interesuar. Mesa duket “The Reds” ka vendosur ta zëvendësojë Salahun me një veteran si Harry Kane.

Nagelsmann: Ishim të frikësuar pas golit të dytë

Trajneri i Gjermanisë, Julian Nagelsmann, duke folur për “Rai Sport” pas barazimit shpërthyes 3-3 ndaj Italisë, ka thënë se është i lumtur që skuadra e tij është kualifikuar në gjysmëfinale të Ligës së Kombeve por, sipas tij, Gjermani nuk luajti mirë në pjesën e dytë të kësaj sfidë dramatike. Strategu gjerman e pranon se pas golit të dytë të pësuar, ai dhe bankina e skuadrës së tij ishin të frikësuar. “Nuk e nisëm mirë në pjesën e dytë. Pasi pësua golin e dytë, ishim pak të frikësuar”, ka thënë Nagelsmann. “Do të jetë e rëndësishme që Gjermania të dalë mirë në gjysmëfinale. Janë skuadra shumë të forta dhe të luash në shtëpi do të jetë edhe më stimuluese”, ka theksuar Nagelsmanni.

Conceicao: Te Milani për ta fituar Ligën e Kampionëve

Sergio Conceicao i ka idetë e qarta. Trajneri portugez u shpreh se ka shkuar te Milani, për ta fituar Ligën e Kampionëve. “Doja të shkoja në një nga kampionatet më të forta në botë. Kam ëndrrën dhe objektivin për ta fituar Ligën e Kampionëve, ndaj për këtë arsye zgjedha klubin tim aktual. E dija që do të përballesha me vështirësi, sepse nuk e kam ndërtuar unë skuadrën. Nuk kam kohë për stërvitje. Pavarësisht prej këtyre fakteve, kam detyrimin për të fituar. Megjithatë, është një klub historik që më jep mundësinë për t’iu afruar një prej objektivave të karrierës sime, pas shumë trofeve të fituar në Portugali”, ka thënë Conceicao.

Barcelona interesohet për Isakun

Barcelona ka nisur të mendojë që tani për merkaton e verës, pasi synon t’i ofrojë trajnerit Hansi Flick një tjetër sulmues qendror që garanton gola. Bëhet fjalë për

Alexander Isak, sulmuesi i skuadrës së Newcastle. Suedezi është shumë i pëlqyer nga drejtuesit katalanas dhe padyshim që do të jetë një nga

objektivat e sezonit të transferimeve të verës. Me kontratë deri në vitin 2028, sulmuesi po kalon një sezon të mrekullueshëm me bardhezinjtë,

duke shënuar 23 gola në 33 ndeshje në Premierë Ligë, Kupën e Ligës dhe FA Cup. Negociatat nuk kanë nisur, por ekziston një dëshirë nga skuadra spanjolle për

të tentuar në verë. Sipas “El Nacional”, Isak është i hapur për një transferim të mundshëm në La Liga për sezonin e ardhshëm, konkretisht te Barcelona.



- Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

-



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mustafa Haki Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.



044 900 978 | 045 681 898

 [Sallon Depilimi Lume's Details](#)

 [lumesdetails](#)

 Mbrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

